



Pranuar / Dorezuar Pimljen/Prodato Received/Delivery	19 - 10	2	viti god year
Organ /Njësia Organ /Jednica Org./Unit	Nr. Prot Br. Prot Prot. No	Shtojca e Prilog Appendix	Sasia Kolicina Quantity
SKIMSHOK	6310/2022		1/6



## Republika e Kosovës Republika Kosova – Republic of Kosovo

KËSHILLI I PAVARUR MBIKËQYRËS PËR SHËRBIMIN CIVIL TË KOSOVËS  
NEZAVISNI NADZORNI ODBOR CIVILNE SLUŽBE KOSOVA  
INDEPENDENT OVERSIGHT BOARD FOR THE CIVIL SERVICE OF KOSOVO

A.nr.771/2022

Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës-Kolegji për Shqyrtimin dhe Vendosjen e Ankesave në përbërje nga: Arditë Haxhnikaj-Demi-kryetare, Malsore Gashi Bajraktari dhe Eshref Shabani-anëtarë, me Avdyl Bekteshi-Zyrtar i Lartë për Bashkëpunim Profesional në cilësinë e procesmbajtësit, ka shqyrtuar ankesën me numër A.nr.771/2022 të datës 06.09.2022 të parashtruar nga ankuesi \_\_\_\_\_ me adresë banimi në Fshatin \_\_\_\_\_ i kundër organit të punësimit Komunës së Shtimes, në çështjen juridike “shkelje e së drejtës së pagës”, duke vepruar në pajtim me Nenin 6 paragrafin 1 nënparagrafin 1.1, Nenin 16 paragrafi 3 dhe Nenin 18 paragrafin 1 nën paragrafin 1.3 të Ligjit Nr. 06/L-048 për Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, në seancën për këshillim dhe votim të mbajtur me datë 19.10.2022, njëzëri, mori këtë:

### V E N D I M

- I. **Aprovohet pjesërisht si e bazuar** ankesa me numër A.nr.771/2022 e datës 06.09.2022 parashtruar nga ankuesi \_\_\_\_\_ lidhur me pretendimin për harmonizimin e koeficientit të pagës për pozitën e punës Inspektor i Komunikacionit dhe Shërbimeve Publike si dhe **Obligohet** Kryetari i Komunës së Shtimes, që brenda afatit prej 15 ditësh nga data e pranimit të këtij vendimi të inicioj veprimet e nevojshme ligjore për harmonizimin e koeficientit të pagës së ankuesit nga koeficienti gjashtë (6) në tetë (8).
- II. **Refuzohet** pretendimi ankimor i ankuesit për kompensimin material të koeficientit të pagës lidhur me ushtrimin e detyrës së Drejtorit të Qendrës për Punës Sociale nga data 27.08.2020 deri në zbatimin e këtij vendimi si dhe kompensimin në mënyrë retroaktive të diferencës së koeficientit të pagës sipas Akt-Emërimit të datës 15.03.2019 për periudhën nga data 15.03.2019 deri në zbatimin e këtij vendimi.
- III. **Shfuqizohet** Vendimi 02 Nr.392 i datës 27.08.2020 të Kryetarit të Komunës së Shtimes.
- IV. Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës duhet të njoftohet me shkrim lidhur me veprimet e ndërmarra për zbatimin e këtij vendimi.



## A r s y e t i m

Ankuesi i punësuar në Komunën e Shtimes, më datë 06.09.2022 ka parashtruar ankesë me numër protokoll 5169/2022 në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, me pretendimet ankimore për njohjen e së drejtës së kompensimit material të koeficientit të pagës nga gjashtë (6) në tetë (8) për pozitën e punës që ushtron me Vendimin 02 Nr.392 të datës 27.08.2020 si Drejtori i Qendrës për Punë Sociale si dhe ngritjen e koeficientit të pagës nga 6 në 7.5 lidhur më pozitën e Inspektorit për Komunikacion dhe Shërbime Publike, duke përfshirë edhe kompensimin në mënyrë retroaktive periudhën nga data 15.03.2019 e tutje.

Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës bazuar në dispozitat e Rregullores Nr.02/2018 për Procedurën e Shqyrtimit dhe Vendosjen e Ankesave, më datë 12.09.2022 ka proceduar kërkesën për përgjigje në ankesë të Komuna e Shtimes, ndërsa kjo e fundit më datë 13.09.2022 ka përcjell shkresat lidhur me këtë çështje ankimore.

*Kolegji për Shqyrtimin dhe Vendosjen e Ankesave, për vërtetimin e plotë dhe të drejtë të gjendjes faktike si dhe vendosjes në mënyrë meritore, ka administruar këto prova:* Ankesën A.nr.771/2022 e datës 06.09.2022 me numër protokoll 5169/2022 drejtuar Këshillit të Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës; E-mailin e datës 18.08,2022 nga \_\_\_\_\_ për ankuesin; Kërkesën e datës 12.08.2022 nga ankuesi për \_\_\_\_\_ Kërkesën me Nr. 08/216 e datës 20.12.2019 nga ankuesi; Kërkesën me Nr. 08-1/50 e datës 14.07.2020 e ankuesit; Vendimin me numër 02Nr. 392 të datës 27.08.2020 nga Kryetari i Komunës; Ndryshimi dhe Plotësimi i Aktit të Emërimit me Nr.02/113 i datës 15.03.2019; Kërkesën për përgjigje në ankesë e datës 12.09.2022; Përgjigjen në ankesë e datës 13.09.2022; Listën e pagave për ankuesin për muajin gusht dhe korrik 2022; Njoftim nga Ministria e Punëve të Brendshme me Nr.569 e datës 17.07.2020; Formularin e Planit Individual të Personelit i viti 2022, emalin e datës 12.10.2022 nga KPMSHCK-ja për Udhëheqësin e Njesisë së Burimeve Njerëzore të Komunës së Shtimes, emaili i datës 13.10.2022 se bashku me provat shtesë: Akt Emërimi me numër protokoll 0811/12 i datës 31.01.2011 lidhur me nëpunësin civil \_\_\_\_\_ Ndryshim dhe Plotësim i Akt Emërimit me numër protokoll 02/117 të datës 15.03.2019 lidhur me nëpunësin \_\_\_\_\_ Ndryshim dhe Plotësim me numër protokoll 0211/30 të datës 05.02.2013 lidhur me nëpunësin civil \_\_\_\_\_ Akt Emërimi me numër protokoll 0211/12 i datës 31.01.2011 lidhur me nëpunësin civil Rr. \_\_\_\_\_ emailin e datës 19.08.2022 nga Udhëheqësi i Divizionit të Pagave dhe Zhvillimit të Strukturave Funktionale të Departamentit për Menaxhimi e Zyrtarëve Publikë.

Kolegji për Shqyrtimin dhe Vendosjen e Ankesave pasi ka shqyrtuar të gjitha shkresat e lëndës të parashtruara nga palët në procedurë, ka konstatuar së ankesa e ankuesit, *është e pjesërisht e bazuar, sepse:*

Nga administrimi i provave materiale rezulton së ankuesi është i punësuar në Komunën e Shtimes gjegjësisht sipas Aktit-Ndryshim dhe Plotësim i Aktit të Emërimit me numër protokoll 02/113 të datës 15.03.2019, i njëjti është emëruar në pozitën *Inspektor i Komunikacionit dhe Shërbimeve Publikë* me koeficient gjashtë (6), ndërsa sipas listës së pagave të muajit korrik dhe gusht 2022 konstatohet së klasa profesionale e ankuesit është Profesional 1.



Me tej nga vlerësimi i provave të lëndës Kolegji ka gjetur së me Vendimin 02 Nr.392 të datës 27.08.2020 të Kryetarit të Komunës së Shtimes, ankuesi është caktuar të kryej detyrat e Drejtorit të Qendrës për Punë Sociale në Komunën e Shtimes, e të cilën pozitë ankuesi vazhdon ta ushtroj.

Ankuesi fillimisht me datë 14.07.2020 ka parashtruar kërkesë të organi i punësimit për harmonizim të koeficienti të pagë nga gjashtë (6) në shtatë pikë pesë (7.5) lidhur me pozitën sipas Akt Emërimit të datës 15.03.2019, ndërsa me datë 12.08.2022 i është drejtuar me kërkesë Udhëheqësit të Personelit të Komunës së Shtimes, se meqenëse i njëjti ushtron pozitën e Drejtorit të Qendrës për Punë Sociale t'i bëhet ngritja e koeficientit të pagës nga gjashtë (6) në tetë (8) duke përfshirë edhe kompensimin material të diferencës së koeficientit nga data 27.08.2020 si dhe kompensimin material të koeficientit të pagës nga gjashtë (6) në shtatë pikë pesë (7.5) për pozitën e inspektorit të komunikacionit dhe Shërbimeve Publike për periudhën nga data 15.03.2019 deri me 26.08.2022. Udhëheqësi i Personelit në përgjigje të kërkesës së ankuesit të datës 12.08.2022 ka njoftuar ankuesin se: *" me Vendimin me numër 02 Nr.392 të datës 27.08.2020 jeni caktuar të kryeni detyrat e Drejtorit të Qendrës për Punë Sociale deri në përfundimin e procedurave të konkursit dhe në të është cekuar që nuk do të ndryshohet koeficienti i pagesë, duke e udhëzuar që mund të parashtron ankesë në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës.*

Ankuesi brenda afrit ligjor parashtron ankesë në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, për harmonizim të koeficient të pagës si dhe kompensim material duke pretenduar së koleget e tij të zyrës që ushtrojnë të njëjtin funksion kanë dhe realizojnë koeficient shtatë pikë pesë (7.5) të pagës, ndërsa ankuesi ka koeficient gjashtë (6) të pagës, kështu që kërkon që Këshilli ti njoh të drejtën e kompensimit material të koeficientit të pagës nga gjashtë (6) në tetë (8) për pozitën e punës që ushtron me Vendimin me numër 02 Nr.392 të datës 27.08.2020 si Drejtor i Qendrës për Punë Sociale si dhe ngritjen e koeficientit të pagës nga gjashtë (6) në shtatë pikë pesë (7.5) lidhur me pozitën e Inspektorit për Komunikacion dhe Shërbime Publike, duke përfshirë edhe kompensimin në mënyrë retroaktive për periudhën data 15.03.2019 deri me 27.08.2020.

Në përgjigjen në ankesë, Komuna e Shtimes deklaroi së nëpunësi që ka mbajtur pozitën e Drejtorit të Qendrës për Punë Sociale ka arritur moshën e pensionimit më datë 25.08.2020 dhe nga kjo datë ka qenë e pamundur të zhvillohet procedura e rekrutimit apo caktim i ushtruesit të detyrës në këtë pozitë, po ashtu nuk kemi zyrtarë të mjaftueshëm që do të kishin plotësuar kriterin e transferimit të përkohshëm nga e njëjta kategori funksionale.

Lidhur me pretendimin e ankuesit për harmonizim të koeficientit të pagës për pozitën e Inspektorit të Komunikacionit dhe Shërbime Publike, Kolegji ju referua nenit 19 të Ligjit Nr.06/L-114 për Zyrtarët Publikë më të cilin është përcaktuar se: *Zyrtari publik ka të drejtë në pagë dhe shpërblim për punën e kryer si dhe shtesa të përcaktuara me Ligjin e Pagave*, si dhe nenit 3 paragrafi 2 të Ligjit Nr.03/L-147 për Pagat e Nëpunësve Civilë më të cilin parashihet se: *Institucionet e administratës publike të Republikës së Kosovës janë të detyruara të paguajnë pagë të njëjtë për punën me vlerë të njëjtë.* Andaj mbi këtë bazë ligjore dhe nisur nga konstatimi si me lart së ankuesi është emëruar në pozitën Inspektor i Komunikacionit dhe Shërbimeve Publike me koeficient gjashtë(6) të pagës, si dhe duke u bazuar në shkresën e datës 19.08.2022 të Departamentit për Menaxhimin e Zyrtareve Publik si organ përgjegjës për përgatitjen dhe mbikëqyrjen e zbatimit të politikave për pagat e zyrtarëve publikë, me të cilin është konfirmuar së pozita inspektor-klasa profesionale



1, ka të përcaktuar koeficient tetë (8) të pagës, Kolegji i Këshillit konstaton së pretendimi ankimor i ankuesi për harmonizimin të koeficientit të pagës me titullin e punës është i drejtë dhe i ligjshëm.

Ndërlidhur me pretendimin ankimor si me lartë, Kolegji duke u bazuar në provat e lëndës ka gjetur se Komuna e Shtimes aplikon koeficient të ndryshëm të pagës lidhur me pozitën *inspektor komunal* gjegjësisht sipas Aktit të Emërimit me numër protokoli 0811/12 të datës 31.01.2011 nëpunësi civil në pozitën Inspektor i Tregut ka të përcaktuar koeficient shtatë pikë pesë (7.5), sipas Aktit të Emërimit me numër protokoli 02/117 të datës 15.03.2019 nëpunësja civile në pozitën Inspektor për Ambient dhe Mjedis ka të përcaktuar koeficient gjashtë (6), sipas Ndryshim dhe Plotësim të Akt Emërimit me numër protokoli 0211/30 të datës 05.02.2013 nëpunësi civil në pozitën e Inspektorit të Bujqësisë ka të përcaktuar koeficient shtatë pikë pesë (7.5), ndërsa sipas Aktit të Emërimit me numër protokoli 0211/12 të datës 31.01.2011 nëpunësin civil në pozitën e Inspektorit të Shërbimeve Publike dhe Komunikacionit pozitë të cilën edhe ankuesi e mbanë ka të përcaktuar koeficient shtatë pikë pesë (7.5), kështu që mbi bazën e këtyre fakteve rrjedhë së zbatimi i koeficienteve të ndryshme të pagës për pozitë të njëjtë të punës brenda institucionit të njëjta punëdhënës paraqet trajtim jo të drejtë dhe diskriminues të ankuesit, dhe rrjedhimisht në gjykimin e Kolegjit veprimet e tilla bien ndesh me dispozitat e nenit 2 dhe 4 të Ligjit Nr.05/L-021 për Mbrojtje nga Diskriminimi si dhe nenin 7 paragrafi 1 të Ligjit Nr.06/L-114 për Zyrtarët Publikë me të cilin parashihet se: *"Menaxhimi i marrëdhënies juridike me nëpunësit civilë, me nëpunësit e Shërbimit Publik dhe me nëpunësit administrativo-teknikë dhe mbështetës, udhëhiqet nga ligji dhe bazohet, gjithashtu, në parimin e mundësive të barabarta, meritës, transparencës, profesionalizmit dhe paanësisë politike, mosdiskriminimit, përfaqësimit të drejtë gjinor dhe të komuniteteve dhe synon garantimin e qëndrueshmërisë dhe vazhdimësisë në detyrë..."*

Ndërsa lidhur me pretendimin ankimore të ankuesit për kompensimin në mënyrë retroaktive të koeficientit të pagës për pozitën e Inspektorit të Komunikacionit dhe Shërbimeve Publike duke filluar nga data 15.03.2019 e tutje, Kolegji bazuar në provat e kësaj çështje nuk ka gjetur asnjë dëshmi së ankuesi pas nënshkrimit të Aktit të Emërimit me numër protokoli 02/113 të datës 15.03.2019 apo dhe pas kërkesës së datë 14.07.2020 të këtë ndërmarr ndonjë veprim juridik lidhur me harmonizimin e koeficientit të pagës apo heshtjes administrative të organit të punësimit lidhur me kërkesën e tij për harmonizim të koeficienti, kështu që Kolegji konstaton së ky pretendim ankimor është i pa bazuar dhe i parashtruar në kundërshtim më nenin 127 paragrafi 1, 3 dhe 4 të Ligjit Nr. 05/L-031 për Procedurën e Përgjithshme Administrative.

Lidhur me pretendimin ankimor të ankuesit për kompensimin material të koeficientit nga gjashtë (6) në tetë (8) lidhur me ushtrimin e detyrës së Drejtorit për Punë Sociale, Kolegji i Këshillit ka analizuar në kuptim të ligjshmërisë Vendimin me numër 02 Nr.392 të datës 27.08.2020 të Kryetarit të Komunës së Shtimes dhe rrjedhimisht ka konstatuar së sipas këtij vendimi ankuesi është caktuar të kryej detyrat e Drejtorit të Qendrës për Punë Sociale në Komunën e Shtimes deri në përfundimin e procedurave të konkursit dhe së të njëjtit nuk do ti ndryshohet koeficientit i pagës. Përkatësisht Kolegji vlerëson së Vendimi 02 Nr.392 i datës 27.08.2020 i Kryetarit të Komunës së Shtimes bazohej vetëm në Ligjin nr.03/L-040 për Vetëqeverisje Lokale pa specifikim të dispozitave ligjore përkatëse si dhe së i njëjti nuk përmban këshillë juridike lidhur me të drejtën e ushtrimit të mjeteve juridike dhe si rrjedhojë baza ligjor





**Avdyl Bekteshi**

*Avdyl Bekteshi*  
**Procesmbajtës**



**Ardita Haxhnikaj-DEMI**

*Ardita Haxhnikaj-DEMI*  
**Kryetare e Kolegjit**

**Vendimi i dërgohet**

- Ankuesit
- Kryetarit të Komunës së Shtimes;
- Udhëheqësit të Burimeve Njerëzore në Komunën e Shtimes dhe
- Arkivit të KPMSHCK-së